

SHTYHET AFATI PËR APLIKIM PËR TRAJNIME PROFESIONALE DHE GRANTE NË BUJQËSI, KOMUNA LIPJAN & MITROVICË

Organizata "Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës" (IADK), është duke zbatuar projektin **"Fuqizimi i grave, burrave dhe të rinjve që jetojnë në zonat rurale me sfida ekonomike, të krijojnë mjete jetese të qëndrueshme nëpërmjet aktiviteteve bujqësore dhe të përpunimit të ushqimit"** projekt tre-vjeçar (2024-2026), i përkrahur nga donatori Zvicran FRIEDA. Projekti do të përfshijë komunat: **Lipjan, Mitrovicë, Shtime dhe Vushtrri**, të cilat janë partnere të projektit. Gjatë vitit 2025 projekti do të zbatohet në komunën e **Lipjanit dhe Mitrovicës**.

Projekti ka për qëllim tri komponentet kryesore të përkrahjes, si: *Ngritja e kapaciteteve përmes Arsimit dhe Aftësimit Profesional, Mbështetja me grante për krijimin e kushteve për gjenerimin e të ardhurave dhe vetëpunësim, si dhe Promovimi i përfshirjes së të rinjve, grave dhe burrave nga zonat rurale në bujqësi.*

Mbështetja e të rinjve me grante: Në kuadër të aktiviteteve të projektit në komunën e Lipjanit dhe Mitrovicës do të përkrahen fermer/e përfitues me grante (në vlerë mesatare 2,000 Euro) në sektorin e bujqësisë (në nënsektorë të ndryshëm të bujqësisë si: perimtar, pemëtar, bletar, blegtor etj). Andaj ftohen fermerët, të rinjtë që të aplikojnë për grantet e lartëcekura.

Kriteret që duhet plotësuar të rinjtë për grante janë:

- a) *Të jenë me moshë mbi 15 vjeç deri në moshën 24 vjeç;*
- b) *Të jenë nga zonat rurale të komunës së Lipjanit dhe Mitrovicës;*
- c) *Të jenë të papunë dhe aktivë në veprimtarit bujqësore;*
- d) *Të kenë resurse për t'u angazhuar në bujqësi (tokë, uji, fuqi punëtore);*
- e) *Të jenë të interesuar për të filluar një biznes apo për t'u vetëpunësuar;*

*Aplikacionet për mbështetjen me grante duhet të dorëzohen deri me datë **26.02.2025**, në ora **16:00**.*

Mbështetja e grave me trajnime profesionale dhe grante në sektorin e përpunimit: Në kuadër të aktiviteteve të projektit është planifikuar formimi i një grupi me 15 pjesëmarrëse nga komuna e Lipjanit përfshirë në projekt, për të cilat do të organizohen 20 ditë trajnime profesionale në sektorin e përpunimit (pemë dhe perime apo qumësht) të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Pas përfundimit të trajnimeve gratë do të pajisen me certifikata të lëshuara nga IADK dhe të verifikuara nga AKK. Pas certifikimit kandidatja më e suksesshme e grupit do të mbështetet me pajisje për njësi të përpunimit, ndërsa kandidatet tjera do të mbështeten me grante të vogla.

Kriteret që duhet plotësuar Gratë për trajnime në përpunim janë:

- a) *Të jenë mbi moshën 16 vjeç;*
- b) *Të jenë nga zonat rurale të komunës së Lipjanit;*
- c) *Të jenë të papuna dhe aktive në përpunim;*
- d) *Të kenë potencial për zgjerim të kapaciteteve të përpunimit;*
- e) *Të jenë të interesuara për të filluar një biznes apo për t'u vetëpunësuar;;*
- f) *Gratë kryefamiljare do të kenë përparësi të përzgjedhjes.*

Programi modular është i Akreditur dhe i validuar nga Autoritetit Kombëtar i Kualifikimit dhe realizohet në pjesën teorike me 30% dhe pjesën praktike 70%.

*Aplikacionet për mbështetjen e grave me trajnime profesionale dhe grante në sektorin e përpunimit duhet të dorëzohen deri në datë **07.03.2025**, në ora **16:00**;*

Aplikacioni mund të merret në zyrat e IADK-së dhe zyrat për bujqësi në komunën e Lipjanit dhe Mitrovicës, mund t'i kërkon në e-mailin: manager.c@iadc.org apo officer.c@iadc.org.